

THIRRJE PËR KUJDES TË SHTUAR GJATË LËVIZJES NË RRUGË ME RASTIN E FILLIMIT TË VITIT TË RI SHKOLLOR 2021/2022



Edhe në rrethanat e pandemisë COVID 19 vitin e kaluar në rrugët e Bashkimit Evropian kanë vdekur 18.880 njerëz, ndërsa në rrugët e Kosovës kanë vdekur 80 njerëz, në mesin e tyre edhe nxënës. Përveç masave të sigurisë së automjeteve, infrastrukturës rrugore, inxhinierisë dhe zbatimit të ligjshmërisë, edukimi konsiderohet si çështja thelbësore që garanton një lëvizje të sigurt në rrugë. Pikërisht përmes edukimit të gjithë përdoruesit e rrugës krijojnë një qasjeje të integruar që do ti bëjë ata më të sigurt kur janë duke lëvizur në rrugë.

Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e lartë në trafik, aksidentet fatale të kësaj vere, gjatë muajit shtator me rastin e fillimit të vitit shkollor, trafiku bëhet më i dendur dhe më i pasigurt për fëmijët. Këtë vit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit së bashku me Akademinë Tempulli dhe Asociacionin Kosovar të Motorizimit AMRKS, ju bëjnë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafik për shtimin e kujdesit gjatë lëvizjes në rrugë. Kjo thirrje për rritjen e sigurisë në rrugë, ju drejtohet të gjithë ngasësve të mjeteve motorike që të janë vigjilentë dhe të veprojnë duke respektuar në plotni rregullat dhe shenjat e trafikut. Në mjedise shkollash, duhet të shtohet kujdesi në mënyrë që të rritet siguria e lëvizjes për fëmijët gjatë rrugës nga shtëpia në shkollë dhe anasjellas. Nga fëmijët kërkohet kujdes dhe vëmendje e shtuar gjatë kalimit të rrugës dhe lëvizjes së tyre në grupe.

Në bazë të hulumtimeve të deritashme me nxënës lidhur me sigurinë e fëmijëve në rrugë, të zhvilluara në shkollat e vendit, ekspertët e këtyre institucioneve japin disa udhëzime dhe rekomandime me masa konkrete për prindërit dhe fëmijët në prag të fillimit të vitit të ri shkollor:

- ⇒ Udhëzohen prindërit që gjithmonë të shoqërojnë fëmijët nën moshën 10 vjeçare nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjellas, përveç kur shkolla gjendet fare në afërsi dhe fëmijët nuk kanë për të kaluar asnjë rrugë;
- ⇒ Prindërit dhe mësuesit duhet të sigurohen se fëmijët e tyre i njohin rregullat e lëvizjes të sigurt në rrugë dhe të sigurohen se ata i njohin shenjat e trafikut që u përkasin atyre;
- ⇒ Shoqërimi i fëmijëve nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjellas duhet të bëhet përderisa prindërit të sigurohen se fëmijët e njohin mjaftueshëm rrugën dhe i praktikojnë në tërësi udhëzimet duke lëvizur të sigurt;
- ⇒ Prindërit dhe mësuesit duhet t'i udhëzojnë fëmijët që të përdorin të njëjtën rrugë çdo ditë dhe të shmangin shkurtesat dhe kryqëzimet e panevojshme, parkingjet, etj;
- ⇒ Fëmijët duhet të kanë veshje komode për të lëvizur lirshëm (jo veshje që kufizojnë lëvizjen e tyre). Mundësisht fëmijëve të ju vendosen në çanta ose në veshje të jashtme shirita fluoreshentë (shndritshëm) për tu vërejtur më lehtë nga pjesëmarrësit tjerë në trafik;
- ⇒ Udhëzojnë dhe mësojnë fëmijët që mos të lëvizin në rrugë ndërmjet automjeteve të parkuara, vend punishteve ose pengesave tjera në rrugë;
- ⇒ Udhëzohen prindërit që të marrin orarin e saktë të fillimit dhe mbarimit të mësimi nga mësuesit ose kujdestarët dhe për çdo ditë të monitorojnë kohën dhe sigurinë e lëvizjes së fëmijëve;
- ⇒ Udhëzohen dhe mësohen fëmijët që gjatë kalimit të rrugës patjetër duhet shikuar në të dyja anët e rrugës para se të kalojnë në anën tjetër të rrugës. Të mos kalojnë rrugën edhe kur në semafor kanë shenjën e ndezur për kalim të lirë, pa i shikuar sërish të dy anët e rrugës dhe pasi të sigurohen atëherë të kalojnë në anën tjetër të rrugës;
- ⇒ Fëmijët duhet të udhëzohen dhe mësohen të mos ndalojnë rrugës dhe nëse ata ndihen të pasigurt të kërkojnë ndihmë nga të rriturit;
- ⇒ Prindërit të sigurohen që transportimi i fëmijëve te tyre, nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas duhet të bëhet në mënyrë të rregullt dhe të sigurt nga kombibusët e licencuar që i drejojnë shoferët me kualifikim përkatës profesional përveç patentshoferit.

Fare në fund, luten të gjithë prindërit që shoqërojnë fëmijët e tyre, të mos bllokojnë me automjetet e tyre hyrje daljet e shkollave. Udhëzohen prindërit që automjetet e tyre t'i parkojnë më larg shkollës dhe të ecin deri te shkolla, në të kundërtën përveç që vazhdimisht bllokojnë rrugët në afërsi të shkollave ata pa dashje rrezikojnë edhe sigurinë e nxënësve.